



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ENERGJISË
DHE INDUSTRIË

DREJTORIA E POLITIKAVE DHE ZHVILLIMIT TE MINIERAVE

Nr. 5854/

Tirane, date 02/12/2016

Drejtuar: Z. BASHKIM ULAJ
SHOQERIA "GENER 2" SHPK
ABA BUSINESS CENTER, FLOOR 7, RRUGA PAPA GJON PALI II
TIRANE

Për njoftim: ZNJ. PRANVERA FAGU, DREJTOR I PERGJITHSHEM
QENDRA KOMBETARE E BIZNESIT
BULEVARDI "ZHAN D'ARK" PRANE MINISTRISË SE JASHTME
TIRANE

Z. VIKTOR TUSHAJ, DREJTOR EKZEKUTIV
AGJENCIA KOMBETARE E BURIMEVE NATYRORE
BULEVARDI "BAJRAM CURRI" BLOKU "VASIL SHANTO"
TIRANE

Z. ALFRED KALO, DREJTOR I KOMANDUAR
REPARTI INSPEKTIM-SHPETIMIT TE MINIERAVE
RRUGA "LORD BAJRON", LAPRAKE
TIRANE

Lënda: Njoftim për fillimin e procedurave te revokimit te lejes nr.1767 date 07.08.2015

I nderuar z. Ulaj,

Shoqëria "Gener 2" shpk është zotëruese e lejes minerare te shfrytëzimit nr.1767 date 07.08.2015 për Gurë Gëlqeror, ne objektin "Polena", Skrapar, Qarku Berat, e cila është marre sipas nenit 23 "Leje shfrytëzimi te karrierave për qëllime publike vendore ose kombëtare" te ligjit nr.10304 date 15.07.2010 "Për sektorin Minerar ne Republikën e Shqipërisë" te ndryshuar, pa kaluar ne proces tenderimi.

Me vendimin e këshillit teknik te Agjencisë Kombëtare te Burimeve Natyrore (AKBN) nr.505 date 19.09.2016, protokolluar ne Ministrinë e Energjisë dhe Industrisë (MEI) me nr.5854 date 28.09.2016 "Dërgohet dokumentacioni përkatës për mbylljen e lejes minerare nr.1767 date 07.08.2015, objekti i gëlqeroreve "Polena, Skrapar, Qarku Berat".

Ne këtë vendim përcaktohet qe te behet miratimi i mbylljes se lejes se shfrytëzimit nr.1767 date 07.08.2015, pasi shoqëria te kryej pagesën ne shumën 160 580 leke, për rehabilitimin e mjedisit, shume te cilën ju e keni paguar me date 01.11.2016, sipas faturës nr.2946 date 11.10.2016, ne degën 29 te Raifeisen Bank, ne llogarinë e Ministrinë e Energjisë dhe Industrisë.

Vendimi i AKBN-se për revokimin e lejes nr.1767 date 07.08.2015 është bere sipas kërkesës tuaj, ne përputhje me piken nr.2 te nenit 47 te ligjit nr.10304 date 15.07.2010 "Për sektorin Minerar ne Republikën e Shqipërisë", te ndryshuar.

[Faint handwritten signature and date 2016]

Sa me sipër ne zbatim te nenit 48 te ligjit nr.10304 date 15.07.2010 “Për sektorin Minerar ne Republikën e Shqipërisë”, te ndryshuar, **ju njoftojmë fillimin e procedurave te revokimit te lejes minerare te shfrytëzimit nr.1767 date 31.07.2015 për Gurë Gëlqeror, ne objektin “Polena”, Skrapar, Qarku Berat, qe shoqëria juaj zotëron.**

Ju bëjmë me dije se pas një periudhe 30 ditore nga ky njoftim, do te merret vendimi për revokimin e lejes minerare te shfrytëzimit nr.1767 date 31.07.2015 për Gurë Gëlqeror, ne objektin “Polena”, Skrapar, Qarku Berat.

Ne zbatim te nenit 49 te ligjit nr.10304 date 15.07.2010 “Për sektorin Minerar ne Republikën e Shqipërisë”, te ndryshuar, duhet te rehabilitoni zonën e shfrytëzimit ne te cilën keni ushtruar aktivitet minerar.

Duke ju falënderuar për mirëkuptimin

MINISTRI

DAMIAN GJIKNURI

